



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 58, Datë 25.06.2009

**PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik” me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Shoqëria SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A, nuk ka raportuar shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik në kohë reale, nëpërmjet regjistrit elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorrike, të instaluar në serverat e Autoritetit dhe nuk ka njoftuar menjëherë Autoritetin për t’i dhënë alternativë tjetër raportimi.

Shoqëria SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A, ka kryer shitje të policave jashtë regjistrit elektronik on line të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm, në datën 22 qershor deri në datën 24 qershor 2009, dhe ka nuk ka marrë asnjë masë për të furnizuar bazën e dhënave të regjistrit elektronik.

Shoqëria SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A ka shkelur dispozitat ligjore për sigurimin dhe të Rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik”, miratuar me vendim Bordi nr.3, datë 03.10.2007 (ndryshuar).

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Të sanksionohet me gjobë në masën 1,500,000 lekë shoqëria “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A, për shkelje të parashikuar në nenin 9 të Rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik”,**

nenit 65 pika a dhe 165, pika 1, shkronja i, të Ligjit nr.9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

2. Të urdhërohet shoqëria “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A :

- a. Të raportojë menjëherë policat e shitura e të paraportuara në Regjistrin Online të Sigurimeve te Detyrueshme Motorrike duke i evidentuar me shenjë të vecantë sipas kërkesave të Drejtorsë të Teknologjisë së Informacionit të AMF-së.**
- b. Të njoftojë klientët mbi 15 shifrat e fundit të numrit të raportimit të gjeneruar nga Regjistri Online i Sigurimeve te Detyrueshme Motorrike, për policat e mësipërme.**
- c. Të raportojë menjëherë në Autoritet për plotësimin e këtyre kërkesave.**

3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Vendimi i bëhet i njohur shoqërisë së sigurimit “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit të tij në faqen elektronike zyrtare të Autoritetit.

K R Y E T A R
Elisabeta GJONI